

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	09.04.2026	Kërkesë për informacion	27.04.2026	Shkrese nr. 7798/1 datë 27.04.2026	E plotë	0
2	14.04.2026	Kërkesë për informacion	21.04.2026	Në përgjigje të shkresës protokolluar në DPSHTRR me nr. 8053 prot., datë 14.04.2026, me anë të së cilës kërkon informacion në lidhje me transportin urban për Bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë, ju informojmë: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhërit Nr. 318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organi kompetent vetëm për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetas të udhëtarëve me autobus dhe nuk ka kompetenca në ushtrimin e veprimtarisë së transportit qytetës/rrethqytetës. Referuar nenit 14, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”, i ndryshuar, transporti i udhëtarëve në linjat e rregullta të transportit qytetës menaxhohet nga Bashkia përkatëse. Për sa më sipër, për marrjen e informacionit të kërkuar, drejtohuni institucionit përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,	E plotë	0
3	15.04.2026	Kërkesë për informacion	28.04.2026	Në përgjigje të shkresës suaj datë 15.04.2026, protokolluar në DPSHTRR me nr. 8120 prot. datë 15.04.2026, “Kërkesë për informacion” lidhur me pajisjen me leje drejtimi për shtetasit e huaj mbi 18 vjeç, të cilët gëzojnë statusin e mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, ju informojmë se: Në zbatim të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 2/a të nenit 311 të VKM-së nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenit 12 të Udhëzimit nr. 9, datë 14.04.2022 “Për aktivitetin e Autoshtetësive” i ndryshuar, të gjithë personat e interesuar, të cilët nuk janë shtetas shqiptarë, mund të pajisen me leje drejtimi të mjetit, pasi të paraqesin dokumentacionin përkatës sipas dispozitave ligjore në fuqi. Faleminderit për mirëkuptimin,	E plotë	0
4	08.05.2026	Kërkesë për informacion	12.05.2026	Referuar pikave 10 dhe 10.1 të Udhëzimit nr. 8, datë 19.12.2019, “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, pas pajisjes me licencë për transport ndërkombëtar rrugor, subjekti aplikon pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në sektorin e autorizimeve të transportit ndërkombëtar, për t’u pajisur me autorizim për operimin në një linjë të rregullt të caktuar dhe/ose në transportin e rregullt të specializuar. Dokumentacioni nga subjekti i interesuar ngarkohet në adresën elektronike: autorizime-transportnderkombetar@infrastruktura.gov.al Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.	E plotë	0
5	26.05.2026	Kërkesë për informacion	29.05.2026	Në vijim të ankesës së referuar, ju bëjmë me dije se për mjetin me targë AA 089 GD, nga verifikimet në sistemet tona nuk rezultoi të jetë paraqitur asnjë kërkesë për ndryshim konstruktiv. Për të aplikuar lidhur me kërkesat për ndryshim konstruktiv, lutemi të ndiqni hapat e përcaktuar në linkun: https://www.dpshttr.al/mjete/ndryshime-konstruktive/apliko-ndryshim-konstruktiv. Duke ju falënderuar,	E plotë	0
6	02.06.2026	Kërkesë për informacion	16.06.2026	Shkresë nr.11667/1, të datës 16.06.2026, lënda "Kthim përgjigje"	E plotë	0

7	11.06.2026	Ankesë	25.06.2026	Në përgjigje të ankesës suaj, për atë që objektet e saj lidhen me kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), ju bëjmë me dije se vijon: Në zbatim të neneve 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, licencimi, administrimi dhe mbikëqyrja e transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve janë kompetencë e njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, konkretisht e Bashkisë Tiranë. Për rrjedhojë, çështjet që lidhen me administrimin e operatorëve të transportit urban, funksionimin e shërbimit, identifikimin e kontrollorëve, si dhe veprimtarinë e institucioneve të tjera publike, nuk janë në kompetencën e DPSHTRR-së. Lidhur me funksionimin e sistemit të kondicionimit në autobusë, sqarojmë se gjatë vlerësimit të kushteve të komoditetit verifikohet edhe ky element, kur autobusi është i pajisur me të. Vlerësimi kryhet mbi bazën e dokumentacionit teknik dhe karakteristikave të mjetit, ndërsa përdorimi i sistemit gjatë ofrimit të shërbimit nuk është objekt i kontrollit të institucionit tonë. Nëse identifikohen mjete konkrete, DPSHTRR është e gatshme, në bashkëpunim me strukturat kompetente, të kryejë një rivlerësim të jashtëzakonshëm të kushteve të komoditetit, në përputhje me kompetencat e saj.	E plotë	0
---	------------	--------	------------	---	---------	---